



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 266 Dt. 05.05.2021
PRISHTINË • PRİŠTINA • PRISTINA

Prishtinë, 05.05.2021

Në bazë të raportit të ndeshjes, raportit shtesë të vëzhguesit, deklaratave të gjyqtarit kryesor, gjyqtari 1, gjyqtari 2, video incizimeve nga ndeshja e V-të gjysmëfinale të FIVE STAR Superligës së Kosovës, Ponte Prizreni vs Peja te rezultati 48:49 e zhvilluar më 04.05.2021 në Prizren, Komesari i Garave pas grumbullimit të dëshmimeve, provave të ndeshjes merr këtë:

Vendim

1. Konform Nenit 39.6.4 të Propozicioneve të Garave gjyqtari i parë në konsultim me vëzhguesin e ndeshjes vendos për ndërprerjen e ndeshjes KB Ponte Prizreni vs Peja pas sulmit ndaj lojtarëve të KB Peja.
2. KB Ponte Prizreni Konform Nenit 49.15 të Propozicioneve të Garave (në pajtim me Nenin 39.6.6) dënohet me 4.000 euro dhe 3 ndeshje pa prezencën e shikuesve për edicionin 2021/22.
3. Konform Nenit 39.6.6 të Propozicioneve të Garave me vendimin e marr nga gjyqtari i parë, ndeshja regjistrohet me rezultat zyrtar 20:0 në favor të KB Peja kurse KB Ponte Prizreni eliminohet nga garat e Play Off-it.
4. Konform Nenit 16.1 dhe Konform Nenit 50.2.1 të Propozicioneve të Garave trajneri i KB Ponte Prizreni, Arbnor Rifati dënohet me 500 euro.
5. Konform Nenit 16.1 dhe Konform Nenit 50.2.1 të Propozicioneve të Garave Kryetari i KB Ponte Prizreni, Zgjim Kryeziu dënohet me 500 euro.
6. Konform Nenit 48.5 të Propozicioneve të Garave KB Ponte Prizreni dënohet me 200 euro.
7. Konform Nenit 48.15 të Propozicioneve të Garave, KB Ponte Prizreni dënohet me 300 euro.
8. Konform Nenit 49.3 të Propozicioneve të Garave KB Ponte Prizreni dënohet me 400 euro.
9. Brandon Walters (KB Peja) Konform Nenit 50.6 të Propozicioneve të Garave dënohet me 400 euro dhe 2 ndeshje mos paraqitje për KB Peja.
10. Aj Walton (KB Peja) Konform Nenit 50.6 të Propozicioneve të Garave dënohet me 400 euro dhe 2 ndeshje mos paraqitje për KB Peja.
11. Leurit Morina (KB Ponte Prizreni) Konform Nenit 50.6 të Propozicioneve të Garave dënohet me 400 euro dhe 2 ndeshje mos paraqitje për KB Ponte Prizreni.
12. Dardan Berisha (KB Peja) Konform Nenit 50.1 të Propozicioneve të Garave dënohet me 100 euro.
13. Konform Nenit 49.11 të Propozicioneve të Garave, KB Peja dënohet me 600 euro.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



RUGOVE GROWZILLAS



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Arsyetim

Vendimet e marra më lartë nga Komesari i Garave janë në bazë të deklaratave të vëzhguesit, gjyqtarit kryesor, gjyqtari 1, gjyqtarit 2, video incizimeve, dëshmime, provave dhe Konform Propozicioneve të Garave për edicionin 2020/21.

Këshilla juridike

Konform Nenit 43.1 të Propozicioneve të Garave është e lejuar ankesa te Komisioni Arbitrar më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit.

Konform Nenit 43.2 paraqitësi i ankesës duhet të deponoj 500 euro në llogarinë e FBK-së.

Konform Nenit 43.3 ankesa e cila nuk dorëzohet me kohë apo shuma e caktuar nuk është deponuar, ankesa refuzohet dhe nuk shqyrtohet.

Konform Nenit 43.6 gjatë ndeshjeve të Play Off-it, Komisioni Arbitrar mblidhet menjëherë merr vendim për ankesën e dorëzuar.

Konform Nenit 43.10 paraqitësi i ankesës ka të drejtë ankesë brenda 24 orëve nga marrja e vendimit.

Konform Nenit 43.11 ankesa në ndeshjet e Play Off-it paraqitet me anë të postës elektronike apo dorëzohet me shkrim.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja " Arbëria " ,Blloku
C3 (Faza 2),Rr. Radovan
Zogoviq,Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



RUGOVE GROWZILLAS

Faton Kurshumlja
Komesari i Garave

Federata e Basketbollit të Kosovës



Prishtinë
05.05.2021